

SHOQERIA "INTERKINEKS"



Vendim nr.1

I mbledhjes së Jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë "INTERKINEKS" Shpk.

Sot më datë 13.9.2007 në Tiranë u bë mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë "INTERKINEKS" Sh.p.k. zotërinjve Xhevdet Shoshi që zotëron 80 % të kapitalit të shoqërisë dhe z.Petrit Sinani që përfaqëson Ndërmarrjen e Filmit Tiranë zotërues i 20 % të kapitalit të kësaj shoqërie.Mbledhja me vota unanime

Vendosi:

- 1- T'i japë të drejtën Z.Xhevdet Shoshi të shesë pjesën e vet prej 80 % të kapitalit që ka në pronësi në shoqërinë "INTERKINEKS" Sh.p.k.
- 2- Ky vendim të depozitohet në zyrën e regjistrimit të shoqërive tregtare pranë gjykatës së rrethit Tiranë

ORTAKET

Xhevdet SHOSHI

Petrit SINANI



**"INTERKINEKS"
SH.P.K**

**VENDIM
I ORTAKUT M**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "INTERKINEKS" eshte reregjistruar person juridik me vendimin nr. 8571 date 15.12.1993 te gjykates shkalles pare Tirane, me ortaket Xhevdet Shoshi dhe Ndermarja e filmit Tirane, perfaqesuar nga drejtori Petrit Sinani, me kapital themeltar 43.147.891 leke i ndare midis ortakeve 80 % ne pronesi te Xhevdet Shoshit dhe 20 % ne pronesi te Ndermarrjes filmit Tirane, me administrator Xhevdet Shoshi. Me vendimin nr. 1 date 13.09.2001 te asamblese se ortakeve eshte vendosur qe ortaku Xhevdet Shoshi te kete te drejte e shitjes te pjeses se tij te kapitalit. Me kerkesen e dates 16.09.2001, ortaku Xhevdet Shoshi i ka afruar shitjen e kuotes se tij te kapitalit ortakut Ndermarjes filmit Tirane, perfaqesuar nga Petrit Sinani. Ortaku Ndermarja e Filmit Tirane, perfaqesuar nga Petrit Sinani shkresen e dates 30.09.2001 i eshte drejtuar ortakut Xhevdet Shoshi dhe i kthen pergjigje qe nuk mund te bleje kuoten e tij te kapitalit dhe i jep te drejte ortakut Xhevdet Shoshi qe ta shesi tek persona te trete kuoten e tij te kapitalit.

Me kontraten e shitblerjes nr.388/45 date 12 shkurt 2002, ortaku Xhevdet Shoshi pjesen e tij 80 % te kapitalit te shoqerise "INTERKINEKS" ja ka shitur Alban Xhillarit me çmimin 353.000 (treqind e pesedhjete e tre mije) dollar. Bleresi kete pagese e ka bere me keste.

Kestet e para jane paguar **10.000 USD** me mandat arketimin nr.002223 date 01.05.2002, **10.000 USD** me mandat arketimin nr.002228 date 01.06.2002, **100.000 USD** me mandat arketimin nr.002222 date 18.06.2002.

Kesti dyte ne shumen **100.000 USD** eshte paguar me mandat pagesen nr.4 ne daten 10.04.2003, **70.000 USD** eshte paguar me mandat pagesen nr.5 ne daten 10.04.2003, **27.850 USD** eshte paguar me mandat pagesen nr.410 ne daten 11.04.2003, **35.150 USD** eshte paguar me mandat pagesen nr.419 ne daten 12.04.2003.

Pjese perberese e kesaj kontrate jane: vendimi nr.1 date 13.09.2001 i mbledhjes se jashtezakonshme te asamblese se ortakeve, kerkese e bere nga

Xhevdet Shoshi ne daten 16.09.2001 per shitjen e kuotave te kapitalit, pergjigja date 30.09.2001 e z.Petrit Sinani.

Ne rrethanat kur ortaku Xhevdet Shoshi ka shitur kuoten e tij te kapitalit eshte larguar nga shoqeria "Interkineks", Alban Xhillari ka blere 80 % te kapitalit. Ortakja Ndermarrja e filmit Tirane perfaqesuar nga Petrit Sinani me 20 % te kuotave te kapitalit dhe Alban Xhillari me 80 % te kuotave te kapitalit, ne mbledhjen e dates 12.06. 2004,

V E N D O S E N:

1. Alban Xhillari i biri i Robertit i datelindjes 1970, banues ne Tirane, rruga "Thanas Ziko", pall.98, shk1, ap.2 te pranohet ortak ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "INTERKINEKS", me 80 % te kuotave te kapitalit.

2. Te largohet nga detyra e administratorit Xhevdet Shoshi te emrohet ne detyren e administratorit Alban Xhillari.

3. Alban Xhillari nga momentin qe ka blere 80 % te kapitalit te shoqerise "INTERKINEKS", merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne bilancin e saj dhe çdo detyrim ndaj te treteve.


4. Te shtojme afatin e veprimtarise se shoqerise edhe 10 vjet te tjera.

5. Te depozitohet ne zyren e regjistrimit tregtar te gjykates shkalles pare Tirane, ky vendim date 12.06.2004 mbledhjes se ortakeve te shoqerise "INTERKINEKS", vendimi nr.1 date 13.09.2001 i mbledhjes se jashtezakonshme te asamblese se ortakeve, kerkese e bere nga Xhevdet Shoshi ne daten 16.09.2001 per shitjen e kuotave te kapitalit, pergjigja date 30.09.2001 e z.Petrit Sinani. Kontrata nr.388/45 date 12 shkurt 2002 i shitblerjes se kapitalit, pagesat e kesteve me mandat arketimet nr.002223 date 01.05.2002, nr.002228 date 01.06.2002, nr.002222 date 18.06.2002, me mandat pagesat nr.4 date 10.04.2003, nr.5 date 10.04.2003, nr.410 date 11.04.2003, nr.419 date 12.04.2003.

Asambleja e Ortakeve

Ndermarja e filmit Tirane
Perfaqesuar nga Petrit Sinani

Alban Xhillari



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Noteria Tiranë

Nr. 388 Rep.

Nr. 45 Kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH (SHOQERIE)

Sot më datë 12 shkurt 2002 (Dymijeedy) para meje noteres Adelina Nini me seli në Rr. Myslym Shyri pall 46/1 u paraqitën personalisht:

Shitësi: Z.Xhevdet Shoshi biri i hajdarit ,I datelindjes 27.08.1950,lindur ne Koshice Kosove,banues ne Prishtine Rr. Velonia 1/2 indentifikuar ne karten e identitetit me fotografi me numur personal 100095717 e leshuar ne date 27.06.2001 nga Misioni i Administrates se perkohshme te Kombeve te Bashkuara ne Kosove

Blerësi: Z.Aiban Xhillari I biri I Robertit I datelindjes 1970 banucs ne Tirane ne Rr. Thanas Ziko pall 98 shk 1 ap 2 I identifikuar me pasaporte 0346030

Shoqëria "INTERKINEKS" Sh.p.k është regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendim Nr. 8571 datë 15.12.1993.Kjo shoqëri përbëhet nga dy ortakë, prej Z.Xhevdet Shoshi që zotëron 80 % (tetëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit dhe Ndërmarrja e Filmit Tiranë e përfaqësuar nga drejtori i saj Z.Petrit Sinani që zotëron 20 % (njëzet përqind) të kuotave të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë tregtare "INTERKINEKS" Sh.p.k. është 43 147 891 lekë (dyzetë e tre milion e njëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një lekë) i investuar në masën 80 % ose 35 402 500 lekë (tridhjetë e pesë milion e katërqind e dy mijë e pesëqind lekë) nga Z.Xhevdet Shoshi dhe 20 % (njëzetë përqind) ose 7 745 391 lekë (shtatë milion e shtatëqind e dyzetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një lekë)e Ndërmarrjes së Filmit Tiranë.

Vlera e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga vlerësimi i objektit te Kino "Partizanit" dhe Kino "Ali Demi" dhe investimet e bëra në këto objekte.

Në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë së ortakëve me vendim Nr. 1 datë 13.09.2001 është vendosur që Z.Xhevdet Shoshi të shesë kuotat e tij prej 80 % . Shitesi Xhevdet Shoshi me shkresen e dt. 16.09.2002 ka njoftuar Ortakun e vet Z. Petrit Sinani dhe ky I fundit me pergjigjen e dt. 30.09.2001 ka rënë dakort qe shitja e kuotave ti behet nje personi te trete.

Shitësi Z.Xhevdet Shoshi i shet Z.Aiban Xhillari ,pjesën e kapitalit të tij prej 80 % me çmimin 355.000 (treqindpesedhjetetremije)USD.

Pagesa do të bëhet me këste në afatet e mëposhtme:

- 1-Kësti i parë prej 140.000 USD ne date 05.03.2002, nqse deri ne kete date eshte kryer edhe hipotekimi i pasurive te INTERKINEX prane Zyres se Hipotekes Tirane.
- 2-Kësti i dytë prej 213.000 USD do të paguhet deri më datë 31.03.2003.

N.q.s blerësi nuk e paguan këstin e fundit në afatin e caktuar në këtë kontratë detyrohet të paguajë si kamatë vonesë 2 % në muaj të shumës të papaguar.

Me pagesën e këstit të fundit shitësi humbet tërësisht pronësinë mbi kuotat e tij dhe blerësi Z. Alban Xhillari bëhet pronar i tyre.

Të gjitha detyrimet që mund të ketë shoqëria "INTERKINEKS" Sh.p.k deri ne daten e neneshkrimit te kesaj kontrate ndaj të tretëve ,do të paguhen nga shitësi.

Pjesë përbërëse të kësaj kontrate janë vendimi Nr.1 datë 13.09.2001 i mbledhjes së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë "INTERKINEKS" Sh.p.k, Kerkese per shitje kuptash e Z. Xhevdet Shoshi i dt. 16.09.2001 dhe pergjigja e Z. Petrit Sinani e dt. 30.09.2001.

Keto dokumenta se bashku me kete kontrate do te depozitohen ne Regjistrin Tregetar prane Gjykatës se shkalles se pare Tirane.




Kjo kontratë pasi u lexua dhe u kuptua, u nënshkrua me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve para meje noteres.

BLERESI
Alban Xhillari
ALBAN XHILLARI

SHITËSI
Xhevdet Shoshi
XHEVDET SHOSHI

NOTER

Adelina NINI



“INTERKINEKX” SHPK

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE



Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “INTERKINEKX” shpk eshte reregjistruar person juridik me vendimin nr.8571 date 15.12.1994 te gjykates shkalles pare Tirane, aktualisht perbehet nga ortaku shtetror Ministria e Ekonomise zoteruse e 20 % te kapitalit perfaqesuar nga znj. Valentina Pine me autorizimin nr.3562/2 prot. date 16.06.2005 dhe ortakun jo shtetror Xhevdet Shoshi zoterues i 80 % te kapitalit, me administrator Xhevdet Shoshi.

Ne daten 16. 06.2005, asambleja e ortakeve beri mbledhjen e saj me rend dite:
- Shqyrtimin e kerkeses date 06.06.2005 te ortakut Xhevdet Shoshi drejtuar ortakut shtetror Ministrise Ekonomise per largimin nga shoqeria “Interkinex” shpk dhe shitjen e kuotes se tij te kapitalit.

Pjesemarrja ne mbledhje e ortakeve ishte qind per qind, mbledhja u quajt e vleshme. Pas diskutimit te rendit te dites u provua se ortaku shtetror Ministria e Ekonomise me shkresen nr.3562/1 prot. date 06.06. 2005, nenshkruar nga Ministri Anastas Angjeli ka kthyer pergjigje se nuk eshte i interesuar per blerjen e kuotes se kapitalit qe zoteron ortaku Xhevdet Shoshi dhe eshte dakort ta transferoj tek te tretet.

Bazuar ne aktin e themelimit, ne statutin e shoqerise, ne ligjin 7638 date 19.11.1992 “per shoqerite tregtare” dhe ligjin 7667 date 28.01.1993 “Per regjistrin tregtar”, asambleja,

V E N D O S I :

1.Te pranoj kerkesen e ortakut Xhevdet Shoshi per largimin e tij nga shoqeria “Interkinex” dhe shitjen e kuotes se tij te kapitalit tek te tretet.

2.Te depozitohen ne zyren e regjistrit tregtar te gjykates shkalles pare Tirane, vendimi asamblese se ortakeve date 16.06. 2005, shkresa nr.3562/1 prot. date 06.06.2005 e Ministrit te Ekonomise, shkresa nr.3562/2 prot. date 16.06.2005 e Ministrit te Ekonomise.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Perfaqesuesi i ortakut shtetror
Valentina Pine 0915226


Perfaqesuesi i ortakut jo shtetror
Xhevdet Shoshi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr...4995...rep.

Nr.....878...kol.



KONTRATE SHITJE

Kapitali

Ne Tirane sot ne daten 25.10.2005 para meje noteres, antare e dhomes se noterise Tirane, u paraqiten palet per te lidhur kontraten e shitblerjes me cilesite si me poshte:

SHITESI: Xhevdet Shoshi i biri i Hajdarit i datelindjes 1950, ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "INTERKINEX" shpk, per identitetin e te cilit u sigurova nga karta e identitetit me fotografi me numer personal 100095717, leshuar ne daten 27.06.2001 nga Misioni i Administrates se Perkoheshme te Kombeve te Bashkuara ne Kosove.

BLERESI: Alban Xhillari i biri i Robertit i datelindjes 1970, banues ne Tirane, rruga "Thanas Ziko", pall. 93/1, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta me nr.Z 0782949.

Ata jane madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe kerkuar redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kapitali.

Shitesi Xhevdet Shoshi eshte pronare i 80 % te kapitalit themeltar te shoqerise "Interkinex" shpk. Kapitali i shoqerise eshte 43.147.891 (dyzet e tre milion njeqind e dyzet e shtate mije e teteqind nentedhete e nje) leke, fakt qe provohet me dokumentat e shoqerise, reregjistruar person juridik me vendimin nr.8571 date 15.12.1993 te gjykates shkalles pare Tirane. Pjesa e kapitalit e shitesit Xhevdet Shoshi e regjistruar ne regjistrin tregtar eshte 35.402.500 (tridhete e pese milion katerqind e dy mije e peseqind) leke. Kapitalin e tij 35.402.500 (tridhete e pese milion katerqind e dy mije e peseqind) leke, shitesi Xhevdet Shoshi ja shiti bleresit Alban Xhillari ne shumen 353.000 (treqind e pesedhete e tre mije) USD.

Bleresi Alban Xhillari ka likujduar shitesin Xhevdet Shoshi per shumen 353.000 (treqind e pesedhete e tre mije) USD me keste si me poshte:

1.Kesti pare ne shumen 10.000 (dhjete mije) USD eshte paguar me mandat arketimin nr. 002223 date 01.05.2002,

2.Kesti dyte ne shumen 10.000 (dhjete mije) USD eshte paguar me mandat arketimin nr. 002228 date 01.06.2002,

3.Kesti trete ne shumen 100.000 (njqind mije) USD eshte paguar me mandat arketimin nr. 00222 date 18.06.2002,

4.Kesti kater ne shumen 100.000 (njqind mije) USD eshte paguar me mandat pagesen nr. 4 date 10.04.2003,

5.Kesti peste ne shumen 70.000 (shtatedhjete mije) USD eshte paguar me mandat pagesen nr. 5 date 10.04.2003,

6.Kesti gjashte ne shumen 27850 (njetzet e shtate mije e teteqind e pesedhjete) USD eshte paguar me mandat pagesen nr. 410 date 11.04.2003,

7.Kesti shtate ne shumen 35.150 (tridhjete e pese mije e njqind e pesedhjete) USD eshte paguar me mandat pagesen nr. 419 date 12.04.2003,

Shitesi Xhevdet Shoshi deklaroi se mori ne rregull shumen 353.000 (treqind e pesedhjete e tre mije) USD me pagesen e gjithe kesteve te pershkruara me siper dhe nga momenti i nenshkrimit te kontrates zhvishet nga pronesia e kapitalit 80 % qe zoteronte ne shoqerine "Interkinex" dhe pronar i kesaj pjese kapitali behet bleresi Alban Xhillari. Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitblerje Alban Xhillari behet pronari i 80 % te kapitalit te shoqerise "Interkinex" dhe ka te drejte ta regjistroi ne regjistrin tregtar.

Palet pasi e lexuan kontraten jane dakort me permbajtjen e saj, me vullnet te plote e te lire e nenshkruan para meje noterit dhe une u vertetoi firmat sipas ligjit.

SHITESI
Xhevdet Shoshi

XH

P A L E T

BLERESI
Alban Xhillari



NOTERE

miratim meje
Shyti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE DHE SHOQERIVE TE VOGLA E TE MESME

Nr. 3562 Prot.

Tiranë, më 16.06.2005

Lenda: Per mbajtje qendrimi ne mbledhjen e asamblese se ortakeve

**PERFAQESUESIT TE ORTAKUT SHTETEROR NE SHOQERINE ME KAPITAL TE
PERBASHKET "INTERKINEX" SHPK
ZJ. Valentina PINE**

TIRANE

Ne zbatim ne Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr.8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", me cilesine e ortakut shteteror ne shoqerine "INTERKINEX" Shpk Tirane, ne mbledhjen e asamblese se ortakeve qe do te mbahet me daten 16.06.2005, ora 14⁰⁰ ne seline e shoqerise, ju autorizoj te mbani kete qendrim:

1. Te miratohet transferimi tek te tretet i pjeseve te kapitalit te zoteruara nga z. Xhevdet Shoshi ne shoqerine "INTERKINEX"Sh.p.k



VENDIM
IMBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
"INTERKINEX" SHPK

Sot, më datë 21.04.2010, bazuar dhe në zbatim të statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", u thirr dhe u mbajt në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 15, Tiranë, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, mbledhje e thirrur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", e cila është vazhdim i mbledhjes së datës 16.04.2010.

Të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë:

- z. Alban Xhillari zotëruar i 80 % të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotëruar e 20% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, e përfaqësuar me Autorizimin Nr. 3581/2 prot, datë 16.04.2010 nga z. Zamir Stefani, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike pranë kësaj ministrie.

Asambleja e Përgjithshme mori në shqyrtimin çështjen e rendit të ditës si më poshtë:

- Miratimin e shitjes nga ortaku Alban Xhillari të 80 % të kuotave të kapitalit të regjistruar që ai zotëron në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK tek blerësi shoqëria "YLDON" SHPK (person i tretë jo ortak), e regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, me ortak të vetëm dhe administrator z. Ylli Ndroqi.
- Miratimin e vendosjes së të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK si kolateral (mjet sigurimi) në të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në favor të Tirana Bank për të siguruar kredinë që shoqëria "YLDON" SHPK do të marrë nga kjo bankë për të financuar çmimin e blerjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK.

[Signature]

financuar çmimin e blerjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK.

- Ndryshimin e administratorit të shoqërisë duke u shkarkuar nga kjo detyrë z. Alban Xhillari dhe emërimin në këtë detyrë të z. Ylli Ndroqi.

Të ndryshme.

Ortakët pasi diskutuan çështjet e rendit të ditës u shprehën dakord për të dhe në përfundim, me unanimitet Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

1. Ti japë miratimin ortakut Alban Xhillari që të shesë 80% të kuotave të kapitalit të regjistruar që ai zotëron në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK tek blerësi shoqëria "YLDON" SHPK (person i tretë jo ortak), e regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, me ortak të vetëm dhe administrator z. Ylli Ndroqi.

2. Të japë miratimin për vendosjen e të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK si kolateral (mjet sigurimi) në të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në favor të Tirana Bank për të siguruar kredinë që shoqëria "YLDON" SHPK do të marrë nga kjo bankë për të financuar çmimin e blerjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK.

3. Të shkarkojë nga detyra e administratorit të shoqërisë z. Alban Xhillari dhe të emërojë në këtë detyrë z. Ylli Ndroqi. Administratori i ri z. Ylli Ndroqi emërohet në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje të këtij afati pas mbarimit të tij.

4. I jepet kompetencë e plotë administratorit të shkarkuar z. Alban Xhillari dhe administratorit të ri Ylli Ndroqi, që vetë personalisht apo nëpërmjet personave të caktuar prej tyre, të veprojnë pranë çdo institucioni shtetëror si dhe çdo subjekti tjetër, me qëllim regjistrimin dhe zbatimin e vendimeve të marra nga kjo Mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme.

ORTAKËT

ALBAN XHILLARI

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

ZAMIR STEFANI

[Signature]

7

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
"INTERKINEX" SHPK

Sot, më datë 21.04.2010, bazuar dhe në zbatim të statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", u thirr dhe u mbajt në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 15, Tiranë, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, mbledhje e thirrur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", e cila është vazhdim i mbledhjes së datës 16.04.2010.

Të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë:

- z. Alban Xhillari zotëruar i 80 % të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotëruar e 20% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, e përfaqësuar me Autorizimin Nr. 3581/2 prot, datë 16.04.2010 nga z. Zamir Stefani, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike të kësaj ministrie.

Ortakët e shoqërisë pasi konstatojnë vlefshmërinë e mbledhjes, deklarojnë se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të zhvillohet dhe të marrë vendimet për të cilat ajo është thirrur.

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "INTERKINEX" SHPK mori në shqyrtim rendin e ditës me çështjet e mëposhtme:

- Miratimin e shitjes nga ortaku Alban Xhillari të 80 % të kuotave të kapitalit të regjistruar që ai zotëron në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK tek blerësi shoqëria "YLDON" SHPK (person i tretë jo ortak), e regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, me ortak të vetëm dhe administrator z. Ylli Ndroqi.

[Signature]

2

- Ndryshimin e administratorit të shoqërisë duke u shkarkuar nga kjo detyrë z. Alban Xhillari dhe emërimin në këtë detyrë të z. Ylli Ndroqi.

Të ndryshme

ZHVILLIMI I Mbledhjes

Ortakët në mënyrë unanime vendosën që mbledhja të drejtohet nga z. Alban Xhillari, në cilësinë e kryetarit. Kryetari cakton si mbajtës të procesverbalit të mbledhjes z. Ardian Ceka.

- I. Kryetari i Mbledhjes lidhur me çështjen e parë të rendit të ditës, sqaron se;

Ortaku Alban Xhillari ka vendosur të shesë kuotat e kapitalit që ai zotëron në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK, të cilat përfaqësojnë 80% të këtij kapitali, në favor të blerësit shoqërisë "YLDON" SHPK (person i tretë jo ortak), e regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, me ortak të vetëm dhe administrator z. Ylli Ndroqi.

Ortaku tjetër i shoqërisë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nëpërmjet përfaqësuesit, bazuar në shkresën nr. 3581/1 prot, datë 16.04.2010 "Lënda: Qëndrimi që duhet të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të shpk "Interkinex", deklaroi se ky ortak nuk dëshiron të ushtrojë të ushtrojë të drejtën e parblerjes për kuotat e kapitalit që do të shesë ortakut Alban Xhillari dhe është plotësisht dakord me shitjen e tyre në favor të shoqërisë "YLDON" SHPK.

Në përfundim të diskutimit të kësaj çështje të rendit të ditës, Kryetari shpall fillimin e procedurës së votimit.

Në përfundim të votimit, Asambleja e Përgjithshme, me unanimitet:

[Signature]

3

VENDOSI

Ti japë miratimin ortakut Alban Xhillari që të shesë 80% të kuotave të kapitalit që ai zotëron në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK tek blerësi shoqëria "YLDON" SHPK (person i tretë jo ortak), e regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, me ortak të vetëm dhe administrator z. Ylli Ndroqi.

- II. Kryetari i Mbledhjes lidhur me çështjen e dytë të rendit të ditës sqaron se;

Shoqëria "YLDON" SHPK financimin e çmimit të blerjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK parashikon ta realizojë nëpërmjet marrjes së një kredi bankare nga Tirana Bank. Tirana Bank ka kërkuar që për efekt të sigurimit të kthimit të kësaj kredie shoqëria "INTERKINEX" SHPK të vërë në dispozicion si kolateral për bankën të gjithë pasurinë e saj të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ortaku Alban Xhillari deklaroi se është plotësisht dakord që e gjithë pasuria e shoqërisë të përdoret si kolateral (mjet sigurimi) në format që do të kërkojë Tirana Bank.

Ortaku tjetër i shoqërisë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nëpërmjet përfaqësuesit, bazuar në shkresën nr. 3581/1 prot, datë 16.04.2010 "Lënda: Qëndrimi që duhet të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të shpk "Interkinex", deklaroi se është dakord që pasuria e shoqërisë të përdoret si kolateral për Tirana Bank për sigurimin e një kredie në favor të shoqërisë "YLDON" SHPK.

Në përfundim të diskutimit të kësaj çështje të rendit të ditës, Kryetari shpall fillimin e procedurës së votimit.

Në përfundim të votimit, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, me unanimitet:

VENDOSI

Të japë miratimin për vendosjen e të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK si kolateral (mjet sigurimi) në të

[Signature]

4

gjitha format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në favor të Tirana Bank për të siguruar kredinë që shoqëria "YLDON" SHPK do të marrë nga kjo bankë për të financuar çmimin e blerjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK.

- III. Kryetari i Mbledhjes lidhur me çështjen e tretë të rendit të ditës sqaron se;

Administratori aktual Alban Xhillari për shkak të largimit të tij nga shoqëria kërkon të lirohet nga detyra e administratorit dhe propozon që administratori i ri të emërohet z. Ylli Ndroqi.

Ortaku Alban Xhillari deklaroi se është dakord për largimin e tij nga detyra e administratorit të shoqërisë dhe emërimin në këtë detyrë të z. Ylli Ndroqi.

Ortaku tjetër i shoqërisë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nëpërmjet përfaqësuesit, bazuar në shkresën nr. 3581/1 prot, datë 16.04.2010 "Lënda: Qëndrimi që duhet të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të shpk "Interkinex", deklaroi se është dakord për largimin e z. Alban Xhillari nga detyra e administratorit të shoqërisë dhe emërimin në këtë detyrë të z. Ylli Ndroqi.

Ortakët shprehën se duke u bazuar dhe në parashikimet e dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori i ri të emërohet në këtë detyrë për një afat 5 - vjeçar, me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati pas përfundimit.

Në përfundim të diskutimit të kësaj çështje të rendit të ditës, Kryetari shpall fillimin e procedurës së votimit.

Në përfundim të votimit, Asambleja e Përgjithshme, me unanimitet:

VENDOSI:

Të shkarkojë nga detyra e administratorit të shoqërisë z. Alban Xhillari dhe të emërojë në këtë detyrë z. Ylli Ndroqi.

Administratori i ri z. Ylli Ndroqi emërohet në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje të këtij afati pas mbarimit të tij.

[Signature]

5

Asambleja e Përgjithshme, me unanimitet, vendosi t'i japë kompetencë të plotë administratorit të shkarkuar z. Alban Xhillari dhe administratorit të ri Ylli Ndroqi, që vetë personalisht apo nëpërmjet personave të caktuar prej tyre, të veprojnë pranë çdo institucioni shtetëror si dhe çdo subjekti tjetër, me qëllim regjistrimin dhe zbatimin e vendimeve të marra nga kjo Mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme.

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim në Asamblesë e Përgjithshme, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbylltur.

Procesverbali nënshkruhet rregullisht nga Kryetari dhe Mbajtësi i Procesverbalit.

KRYETARI

MBAJTËSI I PROCESVERBALIT

ALBAN XHILLARI

ARDIAN CEKA

ZAMIR STEFANI

6

LISTA E PJESËMARRËSVE NË
MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
"INTERKINEX" SHPK

Sot, më datë 21.04.2010, bazuar dhe në zbatim të statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", u thirr dhe u mbajt në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 15, Tiranë, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, mbledhje e thirrur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", e cila është vazhdim i mbledhjes së datës 16.04.2010.

Të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë:

- z. Alban Xhillari zotëruar i 80 % të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotëruar e 20% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, e përfaqësuar me Autorizimin Nr. 3581/2 prot, datë 16.04.2010 nga z. Zamir Stefani, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike të kësaj ministrie.

ORTAKËT


ALBAN XHILLARI

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

ZAMIR STEFANI

[Signature]

1



NDRYSHIM KONTRATË SHITBLERJE
(Kuotash Kapitali)

Sot më datë 14.04.2010 (dymijë e dhjetë), para meje noterit publik, Arian Mërkuri, Anëtar i Dhomës së Noterëve të Tiranës, me zyrë në Rrugën "Reshit Çollaku", Tiranë, u paraqitën personalisht palët të cilët më kërkuan hartimin e kësaj ndryshimi të kontratës së shitblerjes së kuotave të kapitalit Ndr/Kol, Nr. 571/Kol, datë 14.04.2008 për përputhje me Kodin Civil, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me kushtet e mëposhtme:

PALET

- Pala Shitëse:** Alban Xhillari, i biri i Robertit, i datëlindjes më 24.03.1970, lindur dhe banues në Tiranë Rr. "Thanas Ziko", pall 93, i pajohur prej meje noterit, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Z0782949, datë 14.04.2008.
- Pala Blerëse:** "YLDON" SHPK, shoqëri e së drejtës shoqiptare, regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K31618007S, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, përfaqësuar nga ortakut i vetëm dhe administratorin z. Ylli Ndroqi, i biri i Bahrit, dt. 11.03.1965, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajohur prej meje Noterit, për identitetin e të cilit u binda nga karta e identitetit me nr. letërnjoftimi 024650150.

Kushtet paraprake

- Midis palëve të mësipërme është lidhur një kontratë shitblerje kuotash kapitali me Nr. 571/Kol, datë 14.04.2008 përpara meje noterit Arian Mërkuri. Në këtë kontratë palët kanë rënë dakord që pala shitëse Alban Xhillari t'i shesë palës blerëse shoqërisë "YLDON" SHPK 80% të kuotave që ajo zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK, Çmimi i shitjes së kuotave është fiksuar në vlerën 2 900 000 (dy milion e nëntëqind mijë) Euro.
- Pala blerëse shoqëria "YLDON" SHPK ka paguar nëpërmjet kredisë së akorduar nga Tirana Bank një pjesë të çmimit të shitjes prej 2 400 000 (dy milion e katërqind mijë) Euro por nuk ka paguar diferencën prej 500 000 (pesëqind mijë) Euro të parashikuar në pikën III "Çmimi", paragrafi i fundit të kontratës Ndr/Kol, datë 14.04.2008.

• Pala shitëse i ka kërkuar palës blerëse pagimin e plotë të çmimit (pjesën e mbetur të çmimit në vlerën e 500 000 (pesëqind mijë) Euro) për shkak të plotësimit të afatit të parashikuar në pikën III "Çmimi", paragrafi i fundit të kontratës Ndr/Kol, datë 14.04.2008.

• Pala Blerëse shoqëria "YLDON" SHPK i ka deklaruar palës shitëse se në kushtet kur procesi i privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, po vonon përtej parashikimeve të palës blerëse dhe për këtë shkak vlerëson se çmimi i 80% të kuotave të blera prej shitësit, në momentin kur procedura e privatizimit të pjesës së mbetur të kapitalit të shoqërisë, akoma nuk ka filluar, prej 2 900 000 (dy milion e nëntëqind mijë) Euro duhet të rishikohet duke u caktuar në momentin e lidhjes së kësaj kontrate një çmim më i vogël, duke rënë dakord palët që ta rishikojnë përsëri çmimin në një moment të dytë kur të fillojë procesi i privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet.

• Pala shitëse i ka deklaruar palës blerëse se është dakord të rishikohet çmimi i shitjes së 80% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK, deri në momentin e fillimit të procesit të privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet në këtë shoqëri dhe të ripërcaktojnë detyrimin e marrë përsipër prej shitësit në kontratën Ndr/Kol, Nr. 571/Kol, datë 14.04.2008 për pagimin e çmimit të privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet.

Për gjithë sa më lart palët bien dakord të bëjnë këtë ndryshim në kontratën Ndr/Kol, Nr. 571/Kol, datë 14.04.2008 të lidhur midis tyre.

Pika III "Çmimi" ndryshohet si më poshtë vijon:

III ÇMIMI

Palët bien dakord që çmimi i shitjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK, deri në momentin e fillimit të procesit të privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet në këtë shoqëri, të jetë 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) Euro.

Si pasojë e zvogëlimit të çmimit prej 2 400 000 Euro të paguar tashmë nga pala blerëse shoqëria "YLDON" SHPK palët bien dakord që pala shitëse Alban Xhillari t'i kthejë palës blerëse shumën prej 1 200 000 Euro.

Për efekt të kthimit të diferencës së çmimit pala shitëse merr përsipër detyrimin të shlyejë kredinë deri në marrë prej shoqërisë "YLDON" SHPK deri në vlerën e principalit prej 1 200 000 Euro së bashku me interesat mbi këtë principalt sipas kushteve të kontratës që blerësi shoqëria "YLDON" SHPK ka lidhur me Tirana Bank.

Pala blerëse shoqëria "YLDON" SHPK merr përsipër detyrimin të shlyejë vetëm pjesën e mbetur të kredisë bankare prej 1 200 000 Euro (e cila përmban çmimin e ndryshuar të kontratës) së bashku me interesat mbi këtë shumë.

Gjithashtu palët bien dakord që blerësi të çlirohet nga detyrimi për të paguar shumën prej 500 000 Euro shtesë deri në momentin e fillimit të procesit të privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet.

Palët bien dakord që për mënyrën e pagimit të çmimit të privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK ato do të negociojnë përsëri dhe do të shpërbëjnë marrëveshje të veçantë në momentin kur ky proces të fillojë.

Palët bien dakord që çmimi i shitjes së 80% të kuotave të kapitalit prej 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) Euro nuk përshfaq pagesën prej shitësit Alban Xhillari të çmimit të privatizimit të pjesës së kapitalit të ortakut shtet.

Ky ndryshim kontrate hartohet në 5 (peshë) kopje autentike dhe është pjesë integrale e kontratës së shitblerjes së kuotave të kapitalit Ndr/Kol, Nr. 571/Kol, datë 14.04.2008

Ky ndryshim kontrate pasi u lexua me zë të lartë palëve nga unë noter, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshtrova prej tyre në praninë time dhe unë noter e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE
ALBAN XHILLARI

PALA BLERËSE
Shoqëria "YLDON" SHPK
përfaqësuar nga administratori

YLLI NDRQI

NOTER
ARIAN MËRKURI



KONTRATË SHITBLERJE
(Kuotash Kapitali)

Sot më datë 14.04.2010 (dymijë e dhjetë), para meje noterit publik, Arian Mërkuri, Anëtar i Dhomës së Noterëve të Tiranës, me zyrë në Rrugën "Reshit Çollaku", Tiranë, u paraqitën personalisht palët të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me Kodin Civil, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe statutin të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I PALET

- Pala Shitëse:** Alban Xhillari, i biri i Robertit, i datëlindjes më 24.03.1970, lindur dhe banues në Tiranë Rr. "Thanas Ziko", pall 93, i pajohur prej meje noterit, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Z0782949, datë 14.04.2008.
- Pala Blerëse:** "YLDON" SHPK, shoqëri e së drejtës shoqiptare, regjistruar si person juridik me vendim Nr. 29119, datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K31618007S, me seli në Tiranë, Rruga "Qemal Stafa", Nr. 382, përfaqësuar nga ortakut i vetëm dhe administratorin z. Ylli Ndroqi, i biri i Bahrit, dt. 11.03.1965, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajohur prej meje Noterit, për identitetin e të cilit u binda nga karta e identitetit me nr. letërnjoftimi 024650150.

Kushtet paraprake

- Shoqëria "INTERKINEX" SHPK është regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tiranë me vendimin nr. 8571, datë 15.12.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me administrator z. Alban Xhillari, me kapital të regjistruar 43.147.891 (dyzet e tre milion e nëntëqind e dhjetë e shtatë mijë e tetëqind e një) lekë.
- Kapitali i regjistruar kësaj shoqërie njeh nga dy ortakët e sipë.

i) z. Alban Xhillari, zotëruar i 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë

ii) Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës , zotëruar e 20% të kuotave të kapitalit të shoqërisë

Ortakut i shoqërisë, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, është të proces privatizimit të pjesës së saj prej 20% që ajo zotëron në këtë shoqëri. Procedura e privatizimit akoma nuk ka përfunduar.

II OBJEKTI

Nëpërmjet kësaj kontrate palët bien dakord që pala shitëse Alban Xhillari t'i shesë palës blerëse shoqërisë "YLDON" SHPK 80% të kuotave që ajo zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK, shitje kjo e cila është lejuar edhe nga vendimi i datës 21.04.2010, i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK.

Palët bien dakord që pala shitëse Alban Xhillari në momentin e përfundimit të procedurës së privatizimit (shitjes) të pjesës takuese të ortakut shtet (Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës) në këtë shoqëri, në rast se kjo shitje do të bëhet në favor të palës shitëse në këtë kontratë (ortakut të ri të shoqërisë) "YLDON" SHPK të paguarë në emër dhe për llogari të saj, në favor të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës çmimin e privatizimit.

III ÇMIMI

Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK, të jetë 2 900 000 (dy milion e nëntëqind mijë) Euro.

Një pjesë e çmimit të kësaj kontrate në shumën 2 400 000 (dy milion e katërqind mijë) Euro do të paguhet nga pala blerëse shoqëria "YLDON" SHPK në favor të palës shitëse nëpërmjet kredisë bankare që do të akordohet palës blerëse nga Tirana Bank.

Pjesa tjetër e çmimit në shumën 500 000 (pesëqind mijë) Euro do të paguhet nga pala blerëse shoqëria "YLDON" SHPK në favor të palës shitëse brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e pagimit të shumës prej 2 400 000 (dy milion e katërqind mijë) Euro nëpërmjet kredisë bankare.

IV KALIMI I PRONËSISË

Pronësia mbi 80% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "INTERKINEX" SHPK do të kalojë nga pala shitëse, Alban Xhillari tek pala blerëse, "YLDON" SHPK pas pagimit të plotë të çmimit të kontratës nga pala blerëse në favor të palës shitëse dhe depozitimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë.

Nga momenti i pagimit të plotë të çmimit të kontratës dhe depozitimit të kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse, Alban Xhillari humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotat e kapitalit të zotëruara në shoqërinë "INTERKINEX" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga

pala blerëse, "YLDON" SHPK i cili nga ky moment do të bëhet pronar i vetëm i këtyre kuotave.

Kjo kontratë hartohet në 5 (peshë) kopje autentike nga të cilat një qëndron në zyrën e noterisë, një kopje duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), një kopje duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një kopje e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi u lexua me zë të lartë palëve nga unë noter, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshtrova prej tyre në praninë time dhe unë noter e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE
ALBAN XHILLARI

PALA BLERËSE
Shoqëria "YLDON" SHPK
përfaqësuar nga administratori

YLLI NDRQI

NOTER
ARIAN MËRKURI

